

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: PBC SH.P.K., Rr. Idriz Gjilani p.n., 10000, Prishtina Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	04.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **03.08.2023**, nga Operatori Ekonomik: **PBC SH.P.K**, me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“NDËRTIMI I E-KIOSKUT -Ritenderim”** me Numër të prokurimit: **623-23-6912-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-026-5-2-1** nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e pa bazuare Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **PBC SH.P.K**, me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“NDËRTIMI I E-KIOSKUT -Ritenderim”**, me Numër të prokurimit: **623-23-6912-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-026-5-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me me hapat e mëtutjeshem për këtë aktivitetin te prokurimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **PBC SH.P.K**, me adresë në **Prishtinë**, me datë: **04.08.2023** si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“NDËRTIMI I E-KIOSKUT -Ritenderim”**, me Numër të prokurimit: **623-23-6912-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-026-5-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, kundër Njoftimit mbi Vendim të AK-ës të publikuar me **01.08.2023** në linkun <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

- Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.1 citoj:

“Ne si OE pretendimet tona i bazojmë në tërësinë totale të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe Ligjit nr. 05/l -068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 04/l-237, përkatësisht Neni 108/A:

Siç është shpjeguar më lartë, Vendimi i AK është ndërmarrë duke marrë për bazë bazën e gabuar ligjore, dhe bazën aktuale duke e keqinterpretuar.

Një vendim i lëshuar nga AK duhet të ketë bazën e saj juridike, ashtu siç edhe citon paragrafi 9 i Nenit 108/A. Por, duke vepruar në kundërshtim me këtë paragraf, AK nxjerrë një vendim arbitrar, e që dyshimet lindin për faktin që ky vendim është nxjerrë qëllimisht në këtë mënyrë” .

- Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr.1

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.1 **nuk qëndron**. Autoriteti Kontraktues gjegjësisht Komisioni vlerësues ka vepruar konform dispozitave ligjore të përcaktuara me legjislacionin e Prokurimit Publik me që rast ka vepruar në bazë të tabelës për sqarim të tenderëve, të Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik, i cili përcakton:

Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-se

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-se
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjetshëm	69

Tabela e lartë përmendur sa i përket **“problemit”** dhe **“Si të veprohet”** me CV e dorëzuara e që nuk i përmbushin kërkesat nuk ka pësuar as një ndryshim në “Udhëzuesin Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik nga Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik ne te cilin AK është thirrur e që ka qen gabim teknik por vetëm ne referim dhe assesi **ne dispozitë**.

- Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.2 citoj:

“AK me Vendimin e saj vazhdon që të shkelë nenin 59 dhe 72 të Ligjit të Prokurimit Publik. Kjo për faktin që, paragrafi 4 i nenit 59 citon kështu: ‘Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin

material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve’. Që do të thotë se, mospërmbushja e kërkesave nga ana e CV-së nuk paraqet ndryshim të kushtit material apo devijim material. Dhe, nëse AK do të vepronte sipas ligjit, përkatësisht Nenit 72 (citim: ‘Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji’) të LPP, e njëjta do të ftonte OE për të plotësuar dhe qartësuar certifikata dhe dokumentet e paraqitura. Por, fatkeqësisht AK nuk ka vepruar në këtë mënyrë”.

- Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr.2

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.2 gjithashtu **nuk qëndron** ngase në bazë të kësaj të tabelë:

Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-se

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-se
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

AK për CV e cila nuk i plotëson kërkesat e AK-ës nuk ka të drejtë të kërkoj sqarime shtesë në bazë të nenit 72 të LPP-ës.

- Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.3 citoj:

“Në të njëjtën kohë, AK konfuzon OE për shkak që Vendimin që e ka ndërmarrë, e ka ndërmarrë duke u bazuar në rregulloren e shfuqizuar, e që rrjedhimisht këtë vendim e bën të pavlefshëm”.

- **Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr.3**

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. **nuk qëndron** ngase në bazë të kësaj tablele:

Tabela e lartë përmendur sa i përket **“problemmit”** dhe **“Si të veprohet”** me CV e dorëzuara e që nuk i përmbushin kërkesat nuk ka pësuar as një ndryshim në “Udhëzuesin Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik nga Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik ne te cilin AK është thirrur e që ka qen gabim teknik por vetëm ne referim dhe assesi **ne dispozitë**.”

- **Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.4 citoj:**

4. “I ri-kujtojmë AK se, nëse do të kishte respektuar nenin 72, atëherë OE do të përmirësonte gabimin e saj teknik, pasi që, në çdo kohë OE mund të provoj dhe faktoj se CV-jat janë të nënshkruara, dhe njëkohësisht të njëjtit janë të punësuar në OE aplikuese – ku edhe këtë mund të e provojmë dhe faktojmë përmes deklarimeve të bëra në ATK”.

- **Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr.4**

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.4 gjithashtu **nuk qëndron** ngase AK për CV e cila nuk i plotëson kërkesat e AK-ës nuk ka të drejtë të kërkoj sqarime shtesë në bazë të nenit 72 të LPP-ës.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit